

MBILHNI QE TE KORNI



KUVENT

RETO dite në mik na shkruantë në kembim fjalësh që kish bere më në Shqipëtar.

— A do te te mbsoñ shqipën ? — Jo, or zot, ç' me duhën ato mua — Po shqipia është ghuha tëndë, duhët te dish t'a shkruash. — Une s' perzjëhëm ne te tilha punëça. — Funt, ë shoh qe s' do. Po thua-m psëne ë vertëte te kesaj mosdashjë. — Do te vertëten ? Nuke 'dël ulëfëja' më shqipën.

S' dël ulëfëja !... aty është gjithë puna. Po te diltë ulëfëja, gjith' ata Shqipëtare qi sot mohojne ghuhen ë tyrë do t' a ghënin te mire, te bukur ë te shishmë....

Ç' është kio ë Shqipëtarevë qe, pervëç ulëfëse, s' duan ghesëndi ? Bësoñ sé është pertimi. Shqipëtare t' ë duan shume punen; qe nga bujqësia gher në trëgeri te madhë, gjithë mjështërite duan, pak a shume, pune dhë mundimë. Po, per kundre, ç' ghe m' ë lëhte së te jëtë nëriu 'dragat', 'mëmur', 'zaptië', a 'pasha' ?

Është dhë vertët qe trëgeria ne Shqipëri s' behët dot, pervëç ne qytëtët afer dëtit. Ngarko, per trëgim, ca barhe nga ato 'pishq' ë vëres' aqe te shishme te Ohrise per te i shpene jashte. Ca kuaj a mushka, dukë shkuar anes proñvë, neper rhipa ë thika te ngushta ë te rhezikshima, do te biën ë do te mbëtën ne vent ; me tutjë, ndofta do t' dalin kusaret, te te marin ç' kë; ë, ne mbëtte noñe barhe, do t' a arhiñe qelhimin pas shtat a tëtë vjët, ë pishqtë bësoñ sé do te jëtë sadomos pake te prishure.

Perandaj, rhoftë 'ulëfëja !'

Me bië ne ment në ë paçfaqur (*anecdote*) qi rhesën mire deshiren ë Shqipëtarit per ulëfëne.

Pësë-mbe-dhjëte vjët me pare, ñoha ne Shqipëri në pshatarak i cili desherontë te behëj *kolhghi*. Kish në are ë në vrështe, pò s' i punontë ë s' kish buke. Vëntë hantë neper konakët, dukë pritur ulëfëne.

Dhjëte vjët pastaj ë poqa perseri, ë, nga qe me ka pasur githemotin enda te kuvendoj më pshatarakët; ë pyëta s' vëntë. S' mbajta dot te qëshuren kur me tha qe pristë ulëfëne. Dhjëte vjët kish pritur ëdhë s' që lodhur !

Më gjith kete, lë te mos harhojme qe Shqipëtare, sa do pertimtar qe është, i vihët shpëjt punes posa shëh qe puna s' i ka per te vajtur kot. Ndofta kini degtuar sé kenëlhi i Korinthit, ne Grëqi, i cili bashkoj dy dëtë, u-rhemih me shume prëj punetoresh shqipëtare. Punonin, ata djëlmt' ë shendoshe te Shqipërise, punonin, ë, dukë i pare, m' u-mbush zembera më shprëse per fatin ë Shqipërise, sé në komp pertimtar nga rreña, është komp i ngordhur. Nga te gjith' anet

ë Shqiperise, gher nga Prizreni, kishin vajtur te punojne.

Noha atje ne Gege, i cili, ne pake kohe, kish mbsuar te kuvendone gerqishten. Edhe e kuvendonte aqe te shtrember e te shishme, sa kure ne jete t' ime s' kam qeshur aqe, — e u-ndame si miq te vjeter.

TUFE LULESH

DALHENDRYSH, EJA....

O rondinella, che di la dal mare
torni l'antico nido a ritrovare
dimmi,...

DALL' ONGARO.

MIR-SÉ-VJÉN, më krah te léht,
Dalhndrysh, tui fluturué,
Mir-sé-vjén, n' ket an te xéht,
T' dhéut Missirit më dimnué :
Éja, pra, ktu fluturim,
M' gxo më at zâ gith ammécim !

Kur jé nis t' kam porositu
Atjé lérg t' shkojsh kah Shqypnia,
Pra, m' difto, kah kë shétitun,
A t' kan ra n' ménd fjalt é-mia,
Më m' shku n' Shkoder fluturim,
Më m' i u-fal ghytétit t' im ?

Atjé malét ne i-patsh pa,
Jan, préj borét, nalt bardhué,
N' ata fushat ne patsh ra,
Jan më lulé lulezué,
Atjé n' patsh vojtt fluturim,
Aty asht ghytétit i-im !

Barit ñom, gith atjé vèshén
Çuka é kodra, é atjé ndin
Tui kenduè blégtorèshén
Qi kulhot, rhéth, bagetin :
Atjé n' patsh vojtt, fluturim,
Aty asht ghytétit i-im !

N' ghytét t' imin te Shqypri
Trimat léin, qi s' din é 'asht friga ;
Varzat é-bukura t' urtis
Atjé léin, qi s' din é 'asht flhiga :
Atje n' patsh vojtt, fluturim,
Aty asht ghytétit i-im !

Dishroj shum.... por nuk é di
A kam prap fat t' mir më shkué
Ñi hér tjétér ne Shqypri,
Atjé ne Shkoder më kalué....!
Atjé du t' shkoj, fluturim,
T' dés atjé n' ghytétin t' im.

T' kam pas than.... sé n' Fush t' Rmajit
Kam dy vorhé t' dashtunis,
Nan é Bab kam n' at vénv vajit,
Qi m' kan lanun t' vorfenis :
Më za tand t' permalshem shqim
A ké ba mi ta vajtim ?....

A u ké than sé un t' kam çué
Më zan tandin më m' i kja ?
A u ké than sa kam lotué
Kur t' kam nis më shku më i-pa ?...
A é-ké than, t' permalshém shqim,
Kangen tanné gith vajtim ?....

Pra, dalhndrysh, kah kë shétitun,
Ghytétin t' im a é-ké pa,
N' ata vëndét ku ké mritun
N' ménd per mué a t' ka ra,
Më m' shku n' Shkoder fluturim
Më j' u-fal ghytétit t' im ?!

Nga Missiri, me 28 Korik 1895.

GÉG POSTRIPPA.

